



BULETIN

3 – MUJOR/NR. 16
PRILL - QERSHOR 2006

PASQYRA E TITUVJE KRYESORË :

1. VËZHGIME TË KSHH-SË – fq 2
2. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM
EKSPERTIZE LIGJORE – fq 2
 - Gjykata kushtetuese e KSHH-se
 - Ofrim ekspertize & oponenca ligjore
 - Ngritje kapacitetesh administrata
publike
3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE &
EDUKUESE – fq 6
4. PROJEKTE TË REJA - fq 9
5. PUBLIKIME TË KSHH-SË – fq 9
6. TRYEZA DHE KONFERENCA – fq 10
7. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË – fq
11
8. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË – fq 13
9. KOMUNIKIME ME AUTORITETE
SHTETËRORE & ORGANIZATA – fq 13
10. KSHH & MEDIA – fq 13
11. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I
ORGANIZATËS – fq 13

Përgatiti buletin: av. **Etilda SALIU**

Juriste/Koordinatorë projekti

Redaktimi letrar: **Maria MATO**

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN

Nr. 16

PRILL – QERSHOR 2006

*Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbeshtetjen financiare të **CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”***

Gjykata Kushtetuese nuk legjitimon luftën kundër korrupsionit duke shkelur kushtetutën dhe të drejtat e njeriut

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe u njihet e drejta për punë pa asnjë diskriminim

Gjykata Kushtetuese në datën 11.7.2006 dha vendimin përfundimtar të formës së prerë të kërkesës së bërë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Avokati i popullit dhe Grupi shqiptar i të drejtave të njeriut për shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e RSh-së, të tre vendimeve të Këshillit të Ministrave për shmangien e nepotizmit në administratën publike, tatimore dhe atë doganore.

Vazhdon ne faqen 1

Takime të komitetit ekzekutiv të IHF-së dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit me përfaqësues të lartë të shtetit qeverisë shqiptare dhe institucione kushtetuese

Komiteti ekzekutiv i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (IHF) u takua në Tiranë në datat 23-25 qershor 2006, dhe së bashku me Komitetin Shqiptar të Helsinkit morën takime me përfaqësues të Parlamentit, të qeverisë dhe të shoqërisë civile.

Komiteti ekzekutiv i IHF-së u prit nga z. Alfred Moisiu, President i Republikës së Shqipërisë, z. Fatos Beja, Nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryetar i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; z. Aldo Bumçi, Ministër i Drejtësisë; z. Sokol Olldashi, Minister i Punëve të Brëndshme; z. Ermir Dobjani, Avokat i Popullit.

Për më shumë shih materialin faqe 6

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr: Gjin Bue Shpata; Pall. 5/1,
Ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752

Tel: 04 233671
Cel: 068 20 23699;

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

1.1 Matja e aksesit të publikut për veprimtarinë e KShH-së

Gjatë muajve maj – qershor 2006, KShH-ja zhvilloi një anketim për matjen e aksesit të qytetarëve tek veprimtaria, programet, fushat e KShH-së si dhe pritshmëritë e tyre.

Anketimi u shtri në rrethet: Tiranë, Korçë, Fier, Elbasan, Shkodër, Gjirokastër dhe Vlorë ku u anketuan 500 qytetarë dhe 50 gazetarë. Të dhënat e mbledhura nga anketimi do të shërbejnë për hartimin e strategjisë¹ për përcaktimin më mirë të fushave dhe të shërbimeve që KShH-ja do të ofrojë në të ardhmen, si dhe pritshmërinë e përfituesve në fushën e të drejtave të njeriut.

1.2 Respektimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë në pikat e kalimit të kufirit në fokusin e KShH-së

Në kuadër të misionit mbrojtës, edukues dhe sensibilizues lidhur me të drejtat e njeriut, në muajin prill 2006, KShH-ja kreu një raund misionesh vëzhgimi² në disa pika kufitare. Synimi ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga ana e policisë vendëse dhe asaj të huaj, i mënyrës së trajtimit të tyre si edhe evidentimi i problematikave kryesore që hasen në këto pika kufitare me qëllim hartimin e rekomandimeve dhe të sugjerimeve përkatëse për organet përgjegjëse shtetërore për të garantuar një respektim më të mirë të të drejtave të emigrantëve shqiptarë. Ky raund misionesh vëzhgimi u shtri në disa pika kufitare e, konkretisht, në: Muriqan, Kakavijë, Kapshticë, Qafë-Thanë si edhe në portin e Vlorës. Ai u organizua në muajin prill për të monitoruar respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë pikërisht në kohën e fluksit më të madh të tyre në Shqipëri, në kuadër të festës së Pashkëve. Vëzhgimi u realizua nga korrespondentët e KShH-së në rrethe. Për sa i takon metodologjisë së vëzhgimit, korrespondentët morën takime me drejtues dhe disa anëtarë të stafit të policisë së pikave kufitare të vëzhguara, biseduan dhe morën mendimet e emigrantëve shqiptarë që gjendeshin në këto pika kufitare, si edhe vëzhguan nga afër infrastrukturën e sporteve, të mjediseve pritëse dhe të mjediseve të tjera përreth.

1.3 Respektimi i të drejtave të minoriteteve në qytetin e Korçës

Në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”, këshilli bashkiak i Korçës, në mbledhjen e datës 23 maj 2006, mori vendimin për bashkëpunimin e tij në zbatimin e projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”, duke shprehur vullnetin për një zbatim sa më të suksesshëm të tij. Gjatë kësaj periudhe u përgatit një pyetësor dhe u finalizua procesi i shpërndarjes dhe i plotësimit të pyetësorëve tek administrata e Bashkisë së Korçës, qytetarët, përfaqësues të minoriteteve përkatëse, intelektualë, studentë etj. Nëpërmjet plotësimit të këtyre pyetësorëve, administrata e bashkisë bëri një vetëvlerësim të punës së saj lidhur me respektimin e të drejtave të minoriteteve. Gjithashtu, këshilli bashkiak ngriti një grup pune të përbërë prej 5 anëtarësh të këshillit të cilët mbikqyrën procesin e plotësimit të këtyre pyetësorëve.

Në datat 28-29 qershor 2006 u ndërmor një raund vëzhgimi nga stafi i projektit për të vëzhguar ecurinë e procesit për shpërndarjen dhe plotësimin e pyetësorëve të qytetarët e Korçës dhe target-

¹ Përgatitja e strategjisë së KShH për periudhën 2007 – 2010 ka filluar si proces që në fillim të vitit 2006 dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID-it.

² Vëzhgimet u mundësuan financiarisht nga projekti “Monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia kufitare greke”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

grupet e tjera. U realizuan një sërë takimesh pune në qytetin e Korçës me përfaqësues të këshillit bashkiak të Korçës, ekspertë të përzgjedhur dhe korrespondentën e KShH-së në Korçë.

Në përfundim të këtij procesi, nga rezultatet e pyetësorëve do të hartohet një raport për të vlerësuar punën e autoriteteve vendore për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare në respektimin e të drejtave të minoriteteve. Gjithëpërfshirja e qytetarëve të bashkisë së Korçës në përgjithësi dhe e përfaqësuesve të minoriteteve në veçanti është element i rëndësishëm për përfundimin me sukses të këtij procesi si dhe për një vlerësim sa më objektiv të gjendjes së të drejtave të minoriteteve në këtë bashki.

2. OFRIM EKSPERTIZE NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT DHE TË ZBATIMIT TË TIJ

2.1 Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe u njihet e drejta për punë, pa asnjë diskriminim

Në datën 11 korrik 2006, Gjykata Kushtetuese dha vendimin përfundimtar të formës së prerë të kërkesës së bërë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Avokati i Popullit dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të tri vendimeve të Këshillit të Ministrave për shmangien e nepotizmit në administratën publike, tatimore dhe atë doganore.

Shkaqet kryesore të paraqitura nga kërkuesit për shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave ishin: shkelja e parimit të barazisë, e parimit të mosdiskriminimit dhe e drejta e punonjësve për të fituar vetë mjetet e jetesës me punë të ligjshme që e zgjedhin ose e pranojnë vetë; moskompetenca e Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për kufizimin e të drejtave të shtetasve; efekti prapaveprues i këtyre vendimeve.

Në arsyetimin e vendimit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese u jepet të drejtë argumenteve të paraqitura nga kërkuesit duke arsyetuar se Kushtetuta i jep garanci individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit dhe ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit duke mos justifikuar ndërhyrjet ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj.

Gjithashtu, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese argumentohet se të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj dhe, duke iu referuar mënyrës së formulimit të nenit 17 të Kushtetutës, nuk i është lënë asnjë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër, përveç Kuvendit, si organ përfaqësues. Gjykata Kushtetuese është shprehur edhe për efektet që krijojnë vendimet e Këshillit të Ministrave në marrëdhëniet e punës të krijuara më parë si dhe për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit duke i quajtur ato antikushtetuese, pasi punonjësve që preken nga këto vendime, nuk u sigurohet punë tjetër. Parimet e mësipërme duhet të respektohen edhe sikur këto kufizime të ishin bërë me ligj.

Vendimin e plotë mund ta gjeni në faqen tonë të internetit www.ahc.org.al

2.2 Ofrim ekspertize dhe opoenca ligjore

Gjatë kësaj periudhe, KShH-ja ka ofruar ekspertiza dhe u ka adresuar rekomandime institucioneve shtetërore si dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe të huaja. Në muajin qershor 2006, nëpërmjet një pyetësoi të dërguar nga Bordi i Imigrimit dhe Refugjatëve në Kanada, KShH-ja ka dhënë opinionin e vet për çështje të tilla, si: dhuna në familje, të drejtat e homoseksualëve, gjakmarrja, pluralizmi në Shqipëri.

Nisur nga përvoja e vet në këtë fushë, KShH-ja u shpreh, gjithashtu, edhe për çështjen e gjakmarrjes dhe situatën politike në vend, duke ua përcjellë çështjet e tjera organizatave të cilat kanë ekspertizë në këto fusha.

Në tryeza ose takime të ndryshme³ të organizuara KShH-ja është shprehur për probleme të të miturve, të minoriteteve, për burgjet, për çështje kushtetuese, ligjore etj.

Gjatë muajit maj KShH-ja mori pjesë edhe në një takim të organizuar nga Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut (GSHDNJ) për projektligjin për diskriminimin.

2.3 Ngritje kapacitetesh dhe veprimtari trajnuese për administratën publike

2.3.1 Ofrim asistence teknike

- **Raport për përmirësimin e qendrës së trajnimeve të administratës së burgjeve në Shqipëri**

Në 7 prill 2006, në mjediset e burgut të Vaqarit, KShH-ja organizoi një sesion pune me qendrën e trajnimeve të administratës së burgjeve. Pjesëmarrës në këtë sesion pune ishte stafi i qendrës së trajnimit dhe eksperti z. Jan van den Brand, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve në Holandë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte nxitja e diskutimeve për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të statusit aktual, strukturës dhe kurrikulës së kësaj qendre trajnimit duke iu referuar modeleve të ofruara nga vendet e tjera. Përfaqësuesit e qendrës së trajnimit prezantuan nevojat dhe sfidat e tyre për sa i përket statusit, strukturës së kësaj qendre dhe kurrikulave të trajnimit.

Eksperti i huaj u prezantoi pjesëmarrësve një vështrim gjithëpërfshirës lidhur me statusin, detyrat dhe zhvillimet e qendrës së trajnimit në Holandë, situatën e moduleve kryesore të trajnimit për punonjësit e burgjeve si edhe të trajnimeve të tjera shtesë profesionale për kurset e nivelit të mesëm dhe të lartë menaxhues të stafit me uniformë dhe stafit civil të burgjeve. Pjesëmarrësit u njohën me modelet kryesore të trajnimeve bazë të cilat mund të ndihmojnë drejtuesit e kësaj qendre për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave. Gjatë sesionit të punës u dhanë rekomandime për përmirësimin e statusit të qendrës së trajnimit si edhe për hartimin e një plani strategjik të paktën për 3 vjet ku të përcaktohen hapat e zhvillimit të kësaj qendre për këtë periudhë kohore.

- **Sesioni i katërt i punës me administratën e burgut të Lezhës⁴**

Në kuadër të rritjes së shkallës së kapaciteteve të administratës së burgjeve, në datat 5-6 qershor 2006, KShH-ja organizoi sesionin e katërt të punës me administratën e burgut të Lezhës. Objektivat kryesorë të këtij sesioni pune ishin: përmirësimi i programit ditor të aktiviteteve në burgje, struktura e komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm për realizimin e këtij programi ditor, rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të lartë dhe të mesëm drejtues të burgjeve në procesin e menaxhimit të programit ditor si edhe gjetja e mundësive për punësimin e të dënuarve në burgun e Lezhës, si pjesë përbërëse e programit të ardhshëm ditor. Ndër rekomandimet që iu dhanë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ishin: ulja e mbipopullit, mundësimi i punësimit të të dënuarve, aktivitetet kulturore, ngritja e grupeve të veçanta të punës sipas sektorëve përkatës për punësimin e të dënuarve. Në këtë sesion ofroi ekspertizën e tij eksperti Jan van den Brand.

³ Shih më hollësisht në faqen 15, listën e veprimtarive në të cilat përfaqësues të KShH-së kanë ndjekur dhe kanë dhënë ndihmesën e tyre me komente apo me rekomandime.

⁴ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KSHH-së: "Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri-Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit si dhe rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike dhe njohja e tyre me të drejtat e njeriut si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë", i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

2.3.2 Këshillime ligjore ofruar administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve⁵

Takime këshillimore

Gjatë muajve maj – qershor 2006, KShH-ja ka realizuar disa takime këshillimore me të dënuar që vuajnë dënimin në institucionet e rie dukimit të Rrogozhinës, Kosovës, Burrelit, Tepelenës dhe të Krujës. Qëllimi i takimeve këshillimore ishte dhënia e konsulencës ligjore falas dhe njohja e të dënuarve me të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në ligj.

Temat ligjore të trajtuara me të dënuarit u përzgjedhën në bazë të nevojave paraprake të prezantuara nga personeli i këtyre institucioneve si edhe nga kërkesat e vetë të dënuarve. Ndihma ligjore iu dha të dënuarve në grup edhe në mënyrë individuale. Gjatë takimeve këshillimore grupi i juristëve mori takime me drejtuesit e këtyre institucioneve.

2.3.3 Takime pune me përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore

- **Takime pune me drejtorin e përgjithshëm të Burgjeve**

Për të vlerësuar rezultatet e arritura nga sesionet e punës të organizuara me administratën e burgut të Lezhës dhe nga takimi i parë koordinues për prezantimin e projektit të ri në institucionin e paraburgimit Lezhë⁶, KShH-ja realizoi një takim pune me z. Sajmir Shehri, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve⁷. U diskutuan çështje të rëndësishme për burgun e Lezhës si edhe u ngritën disa shqetësime të evidentuara nga administrata e këtij institucioni, si: krijimi i lehtësirave të nevojshme për stafin e burgut me vendbanim larg vendit të punës, gjetja e mundësive për transferimin e disa të miturve që aktualisht ndodhen në këtë burg, në institucione të caktuara për ta. U shprehën vlerësime për përpjekjet e bëra nga administrata e burgjeve lidhur me punësimin e të dënuarve.

Në këtë takim u diskutua, gjithashtu, rreth veprimtarive që do të realizohen në të ardhmen sidomos për qendrën e trajnimit të burgjeve, trajnimet dhe këshillimet për administratën e dy burgjeve që do të hapen në Fushë-Krujë dhe Korçë. Z. Shehri shprehu interesimin e institucioneve që ai përfaqëson, për të bashkëpunuar si partnere serioze në procesin e përmirësimit të situatës së të drejtave të njeriut në burgje.

3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

3.1 Sensibilizimi i qytetarëve dhe i institucioneve shtetërore kundër punës së fëmijëve

Në kuadër të fushatës ndërkombëtare kundër abuzimit të punës së fëmijëve, në Ditën Ndërkombëtare Kundër Abuzimit të Fëmijëve në Punë, KShH-ja iu bashkua thirrjes së Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) për të marrë pjesë së bashku në fushatën sensibilizuese.

Në kuadër të kësaj fushate, CRCA-ja organizoi një protestë paqësore përpara Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale duke i bërë thirrje qeverisë të marrë masa urgjente për parandalimin e kësaj

⁵ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KShH-së “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri- Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit, rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike, njohja e tyre me të drejtat e njeriut si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë”, i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

⁶ Për më tepër informacion, referohuni raporteve lidhur me tematikën e veprimtarisë në burgun e Lezhës dhe projektin 1- vjeçar të paraburgimit në Lezhë.

⁷ Në këtë takim pune mori pjesë z. Jan van den Brand, ekspert i huaj dhe përfaqësues të KShH-së.

dukurie. Në këtë protestë u bashkuan organizata të ndryshme vendëse, qytetarë, fëmijë, për të mbështetur moshatarët e tyre, me banderola të shkruara me mesazhe drejtuar qeverisë dhe duke u fryrë bilbilave për të tërhequr vëmendjen⁸.

Me këtë rast organizatat iu drejtuan qeverisë shqiptare, gjithë institucioneve përgjegjëse dhe opinionit publik me një deklaratë të përbashkët ku bëhej thirrje për parandalimin e kësaj dukurie tepër të dëmshme, jo vetëm për këta fëmijë dhe familjet e tyre, por edhe për të ardhmen e shtetit shqiptar, pasi abuzimi në punë i fëmijëve sjell përfshirjen e tyre në vepra penale, në grupe të organizuara kriminale, shfrytëzimin nga persona të tjerë, mosarsimin dhe duhur etj.

3.2 Takime të IHF-së dhe të Komitetit Shqiptar të Helsinkit me përfaqësues të lartë të shtetit dhe të institucioneve kushtetuese

Në datat 23-25 qershor 2006, Komiteti ekzekutiv i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (IHF) së bashku me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, morën takime me përfaqësues të Parlamentit, të qeverisë dhe të shoqërisë civile.

Komiteti ekzekutiv i IHF-së u prit nga z. Alfred Moisiu⁹, president i Republikës së Shqipërisë; z. Fatos Beja, nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe kryetar i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; z. Aldo Bumçi, ministër i Drejtësisë; z. Sokol Olldashi, ministër i Punëve të Brendshme; z. Ermir Dobjani, Avokat i Popullit.

Në këto takime u diskutua rreth situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri, reformës ligjore dhe respektimit të të drejtave të njeriut, rolit të shoqërisë civile në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe në integrimin e vendit në familjen europiane. Komiteti ekzekutiv i IHF-së shprehu shqetësimet e veta rreth respektimit të të drejtave të njeriut, ndërsa merren masa për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe për nevojën e respektimit të pavarësisë së pushteteve dhe rritjen e efektivitetit të sistemit gjyqësor shqiptar.

4. PROJEKTE TË REJA

4.1 Drejtimi i institucioneve të paraburgimit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut

Me mbështetjen financiare të Fondit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, pranë Departamentit të Shtetit të ShBA-së, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB), KShH-ja filloi zbatimin e projektit njëvjeçar për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit, njohjen me të drejtat e njeriut dhe zbatimin e ligjeve nga administrata e paraburgimit në burgun e Lezhës.

Disa nga objektivat kryesorë të veprimtarive të planifikuara janë:

- përmirësimi i standardeve të të drejtave të njeriut në institucionin pilot të paraburgimit;
- rritja e shkallëve të njohurive teorike e sidomos atyre praktike të administratës së seksionit të paraburgimit, Lezhë;
- nxitja dhe mbështetja e ndryshimit të mendësive në trajtimin e të paraburgosurve;
- aftësimi i administratës së paraburgimit për të marrë nisma për hartimin e një plani veprimesh për të mundësuar drejtimin e paraburgimit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe

⁸ Për më gjerë, shih faqen e internetit www.crca.org.al

⁹ Në kuadër të këtij takimi, Presidenca ka nxjerrë një njoftim në datën 23 qershor 2006. Për më shumë, shih faqen e internetit www.president.al

- ndërgjegjësimi i të paraburgosurve për të drejtat dhe mekanizmat mbrojtës të këtyre të drejtave, ofrimi i këshillimeve ligjore falas për të paraburgosurit në këtë institucion.

Për zbatimin e projektit, KShH-ja do të përfshijë ekspertë të huaj me shumë përvojë në drejtimin e institucioneve penitenciare, juristë të kualifikuar në fushën penale, veprimtarë e vëzhgues të të drejtave të njeriut dhe një staf të përkushtuar e me përvojë. Një nga synimet e projektit është që paraburgimi pilot i Lezhës të shërbejë si model për paraburgimet e tjera në varësi të Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të mirëmenaxhimit të institucioneve penitenciare ku respektohen të drejtat e njeriut dhe dinjteti i të paraburgosurve.

4.2 Projekti “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”¹⁰

KShH-ja filloi zbatimin e projektit: “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”. Qëllimi i këtij projektit është vlerësimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në qytetin e Korçës, evidentimi i mundësive për zhvillimin e tyre, rritja e pjesëmarrjes së minoriteteve në vendimmarrjen vendore dhe forcimi i marrëdhënieve të tyre me pushtetin vendor. Zbatimi i këtij projektit do t’u japë qytetarëve një mundësi më shumë për të përfituar nga veprimtaria e administratës vendore dhe për të propozuar përmirësime në politikën për minoritetet. Në të njëjtën kohë, ai do të jetë një mjet për vetëvlerësimin e autoriteteve vendore dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre për problemet e adresuara nga qytetarët.

Për zbatimin e tij, KShH-ja do të bashkëpunojë me qeverisjen vendore e, konkretisht, me këshillin bashkiak të Korçës. Gjithëpërfshirja e qytetarëve të bashkisë së Korçës në përgjithësi dhe e përfaqësuesve të minoriteteve në veçanti do të jetë element i rëndësishëm për një vlerësim sa më objektiv të gjendjes së të drejtave të minoriteteve në këtë bashki.

Bashkia e Korçës është përvoja e parë e këtij lloji e cila mendohet të shtrihet edhe në qytete të tjera të Shqipërisë ku ka minoritete dhe komunitete.

4.3 Projekti “Monitorimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe të personave të kthyer”¹¹

Duke filluar nga muaji qershor 2006, KShH-ja ka filluar zbatimin e një projekti njëvjeçar për vëzhgimin e respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe të personave të kthyer, sipas marrëveshjes së ripranimit. Disa nga objektivat kryesorë të këtij projekti janë: mbrojtja e të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer në kuadrin e marrëveshjes së ripranimit, vëzhgimi i të drejtave të emigrantëve në bashkëpunim me autoritetet shtetërore shqiptare sidomos ato kufitare, bashkëpunimi me median shqiptare për sa u përket çështjeve të informimit dhe trajtimit të çështjeve në fushën e emigrimit dhe të respektimit të të drejtave të shtetasve shqiptarë, kontribuimi në vëzhgimin e të drejtave të emigrantëve në Shqipëri dhe jashtë saj dhe në trajtimin në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Grupi synues i këtij projekti janë qytetarët shqiptarë të kthyer nga vende të tjera në Shqipëri, respektimi i të drejtave të tyre, evidentimi i rasteve të shkeljeve të të drejtave të tyre nga ana e autoriteteve shtetërore shqiptare kufitare dhe atyre të vendeve fqinje ose nga struktura të tjera shtetërore në Shqipëri dhe jashtë saj.

¹⁰ Ky projekt realizohet me mbështetjen financiare të Friedrich Ebert Stiftung.

¹¹ Projekti mundësohet me mbështetjen financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit dhe do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me aktorët kryesorë në këtë fushë.

5. BOTIMET E KSHH-SË

- **Fletëpalosje për të drejtëne lëvizjes të shtetasve shqiptarë dhe trajtimin e tyre në pikat kufitare**

Për t'u ardhur në ndihmë emigrantëve shqiptarë dhe shtetasve të huaj që kalojnë kufirin, KShH-ja ka përgatitur një fletëpalosje. Në të përfshihen informacione për të drejtën e lëvizjes të shtetasve shqiptarë në kufi, për rolin e shërbimeve diplomatike ose konsullore shqiptare jashtë Shqipërisë, për të drejtat e trajtimit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga policia kufitare dhe e emigracionit dhe procedurat që mund të ndiqen kur një shtetas shqiptar ose i huaj është viktimë e dhunës ose e shkeljeve të të drejtave të tjera nga policitë kufitare vendëse dhe të huaja. Fletëpalosja është përgatitur në gjuhët: shqip, anglisht, greqisht dhe italisht dhe është shpërndarë në të gjitha pikat e kalimit tokësor, detar dhe në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit¹².

- **Botimi “Reforma zgjedhore; përsëri me vonesë”**

Në muajin maj 2006, KShH-ja nxori botimin “Reforma zgjedhore; përsëri me vonesë”, me autor z.Niazi Jaho, këshilltar ligjor i KShH-së.

Ky është botimi i tretë për çështje të reformës zgjedhore. Në të përfshihen artikuj dhe intervista të botuara në shtypin e përditshëm gjatë periudhës gusht 2004-shkurt 2006, që trajtojnë çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me dispozitat e Kodit zgjedhor, por edhe me përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën. Në disa shkrime dhe intervista është përqendruar vëmendja në ato probleme që vazhdojnë të jenë objekt-diskutimi, si; sistemi zgjedhor, përbërja, roli dhe funksioni i KQZ-së dhe i komisioneve zgjedhore më të ulëta, fenomeni “dushk” dhe pasojat, listat e zgjedhësve, procedurat e ankimit etj.

Në materialet e këtij botimi jo vetëm ka konstatime, komente dhe vërejtje për çështje të caktuara, por edhe sugjerime për një punë më cilësore për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit zgjedhor.

Artikujt dhe shkrimet e përfshira në këtë publikim mund të shërbejnë në hartimin e projektndryshimeve të Kodit zgjedhor, sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, pa përmendur këtu se materiali i përzgjedhur në këtë botim mund të ndikojë, gjithashtu, edhe në edukimin zgjedhor të shtetasve.

- **Publikimi i raportit bazuar në vëzhgimet e KShH-së**

Pas një rraundi monitorimi në pikat e kalim-kufirit, KShH-ja ka përgatitur një raport i cili është bazuar në përfundimet kryesore të vëzhgimeve. Raporti trajton çështje të ndryshme, si: fluksi i emigrantëve që kalojnë kufirin, trajtimi i emigrantëve nga policia e kufirit, infrastruktura e

¹² Fletëpalosja është përgatitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kufirit dhe të Emigracionit dhe me mbështetjen financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia kufitare greke”.

vendeve të pranimit të emigrantëve dhe e pikave të kalim-kufirit, dukuria e kalimit klandestin të kufirit dhe çështje të tjera, si: kapacitetet e punonjësve në pikat e kalim-kufirit, kushtet e punës.

Raporti i KShH-së është publikuar në faqen e internetit dhe është shoqëruar me rekomandime konkrete për përmirësimin e punës në pikat e kalim-kufirit.

- **STUDIMI “Emigrantët shqiptarë në Greqi”**
(Raste të keqtrajtimit të tyre nga policia greke)

Gjatë periudhës prill-maj 2006, KShH-ja realizoi një punë kërkimore lidhur me rastet e keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë gjatë periudhës 2000-2006. Raporti studimor është bazuar në rastet e denoncuara në KShH, rastet që i janë dërguar Amnesty International dhe monitoruesit grek të Helsinkit. Ai përmban përfundimet dhe rekomandime për masat që autoritetet shtetërore shqiptare dhe greke, policia kufitare e dy vendeve duhet të ndërmarrë për sigurimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe për parandalimin e kalimeve ilegale të kufirit. Raporti studimor është publikuar në faqen e internetit të KShH-së, në gjuhët shqip dhe anglisht.

6. TRYEZA DHE KONFERENCA

6.1 Tryeza të rrumbullakëta

- **Tryezë e rrumbullakët për punësimin e të dënuarve në burgjet shqiptare**¹³

Në 6 prill 2006, KShH-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët për organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e punësimit të të dënuarve në burgje. Në këtë tryezë u diskutua kuadri ligjor shqiptar, projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për zhvillimin e aktivitetit të punës në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale dhe kriteret për shpërblimin e saj”, pozicioni dhe kompetencat e komisionit të punësimit, shpërblimi i të dënuarve të punësuar, menaxhimi i këtij procesi nga ana e burgjeve lokale, numri i të dënuarve që aplikojnë për punë dhe mundësitë e punësimit duke marrë në konsideratë kërkesat, aftësitë dhe rrezikshmërinë shoqërore të tyre.

Krahas sugjerimeve dhe rekomandimeve të ofruara nga ekspertët e huaj, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kishte ngritur një grup pune për të punuar më ngushtësisht me projektvendimin e për ta bërë atë sa më të suksesshëm në zbatimin në praktikë.

Në këtë kuadër, KShH-ja planifikon të organizojë një seminar pune në një burg pilot për zbatimin e një projekti për punësimin e të dënuarve mbështetur në studimet e fizibilitetit dhe në ekspertizën e ekspertëve të huaj. Në këtë aktivitet kontribuan me pjesëmarrjen e tyre përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë¹⁴, z. Lulëzim Kodra, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Burgjeve, drejtues të institucioneve të riedukimit¹⁵ dhe disa përfaqësues të tjerë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në këtë tryezë ofruan ekspertizën e tyre ekspertët e huaj, z. Jan van den Brand dhe z. Peeter Naks¹⁶.

- **Komiteti Shqiptar i Helsinkit do të vazhdojë të jetë oponentë konstruktive për respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut në Shqipëri**

¹³ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KShH-së “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri-Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit, rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike, njohja e tyre me të drejtat e njeriut, si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë”, i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

¹⁴ Përkatësisht nga Drejtoria e Kodifikimit dhe e Institucioneve Penitenciare e Ministrisë së Drejtësisë.

¹⁵ Në këtë tryezë morën pjesë drejtori i burgut të Kosovës dhe drejtoresha e burgut të rrugës “Ali Demi” në Tiranë.

¹⁶ Ekspert për çështjet penitenciare në Misionin e Euraliusit në Shqipëri.

Në datën 6 qershor 2006, Ministria e Brendshme organizoi tryezën e rrumbullakët me temë: “Të drejtat e njeriut-bashkëpunim i hapur për të njëjtin qëllim”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte krijimi i bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe Ministrisë së Brendshme në kontributin e tyre për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Në aktivitet mori pjesë ministri i Brendshëm, z. Sokol Olldashi, drejtori i Policisë së Shtetit, Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit¹⁷, si edhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e ndërtimit të të drejtave të njeriut.

Në këtë takim, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme hodhën idenë e krijimit të një forumi me shoqërinë civile, gjë e cila do të institucionalizojë bashkëpunimin e saj me Ministrinë e Brendshme dhe rezultatet e pritshme në pakësimin e kriminalitetit dhe përmirësimin e të drejtave të njeriut do të jenë më të mira.

6.2 Aktivitete promovuese

- **Promovimi i dokumentarit “Të ndihesh i barabartë – Në Greqi mes emigrantëve”¹⁸**

Në kuadër të misionit sensibilizues për të drejtat e njeriut, në datën 11 maj 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi shfaqjen për herë të parë të filmit dokumentar “Të ndihesh i barabartë – Në Greqi mes emigrantëve”, prodhim i KShH-së dhe art -studios *Grishaj*.

Filmi dokumentar trajton jetën e emigrantëve shqiptarë në shtetin grek, përpjekjet e tyre për t’u integruar në shoqërinë greke, vështirësitë që hasin, përvojat pozitive të integritit të tyre, përpjekjet që ata bëjnë për të realizuar të drejtat e tyre. Ai është realizuar mbi bazën e intervistave me emigrantë shqiptarë dhe qytetarë grekë. Intervistat prekin probleme të ndryshme të emigrantëve shqiptarë që jetojnë në Greqi, që kanë të bëjnë me punësimin, shkollimin e tyre, trajtimin nga popullsia greke. Nuk mbetet pa u prekur edhe trajtimi i shqiptarëve nga policia greke në kufi.

Në këtë film, qytetarë grekë shprehin vlerësimin e tyre për emigrantët shqiptarë. Vend të veçantë në film zënë puna dhe përpjekjet e organizatave të të drejtave të njeriut në Greqi dhe në Shqipëri, kryesisht të shoqatave të emigrantëve shqiptarë dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Dokumentari synon të përcjellë frymën optimiste për një jetë dhe respektim më të mirë të të drejtave të njeriut.

Në këtë aktivitet ishin të ftuar përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore, të ambasadave të akredituara në Tiranë, të organizatave jofitimprurëse shqiptare dhe ndërkombëtare etj.

- **Aktivitet promovues “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”¹⁹**

Në datën 4 maj 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një aktivitet në qytetin e Korçës për të promovuar fillimin e zbatimit të projektit të ri “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”. Objektivat e projektit dhe veprimtaritë që do të zhvillohen në kuadër të tij, u prezantuan në takimin e organizuar me këshillin bashkiak të bashkisë së Korçës. Këshilli bashkiak i këtij rrethi shprehu angazhimin dhe mbështetjen e tij për zbatimin e projektit në bashkinë e Korçës. Në këtë kuadër ishte përgatitur edhe një njoftim për shtyp, i cili, në fund, iu shpërnda përfaqësuesve të medias që ishin të pranishëm në këtë takim.

¹⁷ Ky aktivitetet u mundësua me mbështetjen financiare të CORDAID-it.

¹⁸ Promovimi i dokumentarit u zhvillua në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia kufitare greke”, me mbështetjen financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

¹⁹ Ky projekt mundësohet nga Friedrich Ebert Stiftung.

Gjithashtu, një nga televizionet kryesore lokale të Korçës, TV “Lobi”, kishte realizuar një emision televiziv ku u prezantua projekti dhe objektivat. Të pranishëm në këtë emision ishin përfaqësues të KShH-së dhe kryetari i këshillit bashkiak të Korçës.

- **Takim koordinues për promovimin e projektit të ri njëvjeçar në institucionin e paraburgimit në Lezhë**

Në datën 7 qershor 2006, KShH-ja organizoi një takim koordinues për të bërë të njohur projektin e ri njëvjeçar në institucionin e paraburgimit në Lezhë²⁰. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të ambasadës amerikane, drejtuesit e burgut të Lezhës, administrata e paraburgimit si edhe eksperti i ftuar nga KShH-ja, z. Jan van den Brand²¹. Qëllimi i këtij projekti njëvjeçar është rritja e shkallës së ndërgjegjësimit dhe njohja me të drejtat e njeriut dhe zbatimi i ligjeve nga administrata e paraburgimit në burgun e Lezhës.

Përveç promovimit të programit, qëllimi i takimit të realizuar ishte thithja e mendimeve dhe e opinioneve të administratës së paraburgimit dhe të drejtuesve të tij për çështjet me përparësi, që duhet të trajtohen në sesionet e ardhshme të punës në institucionin e paraburgimit të Lezhës si edhe metodologjia e realizimit të tyre. Në përfundim të takimit, u identifikuan disa nga temat me përparësi për t’u realizuar me administratën e paraburgimit të Lezhës në sesionet e ardhshme të punës, si: procesi i marrjes dhe i pranimit të të paraburgosurve, trajtimi i tyre në aspektin mjekësor dhe edukativ, si dhe përgatitja për kalimin në burg; trajnimi i oficerëve dhe i punonjësve të rolit të bazë që punojnë për sigurinë e brendshme të paraburgimit; organizimi i një programi për trajnim trajnerësh; funksionimi me efikasitet i mekanizmit të kërkesë-ankesës; strukturat komunikuese dhe bashkëpunuese ndërsektoriale, si edhe bashkëpunimi dhe komunikimi i administratës së paraburgimit me mjedisin jashtë institucionit të paraburgimit.

7. SHKETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

7.1 Ankesat

Gjatë kësaj periudhe KShH-ja ka trajtuar **87 letra dhe ankesa**. Objekti i tyre konsiston në: shkeljen e të drejtave të të dënuarve në burgje, kërkesat për transferim të të dënuarve në institucione të tjera të vuajtjes së dënimit, shkeljen e të drejtave nga administrata e burgjeve, ndalimin e së drejtës së korrespondencës, shkeljen e të drejtave gjatë proceseve gjyqësore, kërkesat për këshillime ligjore dhe avokat falas etj.


Ankesat janë marrë nga takimet në zyrë me juristë të KShH-së, nëpërmjet letrave drejtuar në adresën e KShH-së, këshillimeve ligjore etj.

KShH-ja u ka kthyer përgjigje qytetarëve duke u dhënë këshillimin përkatës si dhe u ka kërkuar autoriteteve shtetërore të ndërhyjnë për të zgjidhur çështjet konkrete.

Paraqitja grafike e ankesave:

²⁰ Ky projekt do të realizohet me mbështetjen financiare të Departamentit të Shtetit të ShBA-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

²¹ Në këtë takim morën pjesë konkretisht: z. Charles Morrill, oficer politik, përfaqësues i ambasadës amerikane; znj. Edlira Papavangjeli, koordinatore programesh në KShH dhe drejtuese projekti, si edhe z. Jan van den Brand, drejtor i përgjithshëm rajonal në Holandë.



7.2 Raste të verifikuara nga KShH-ja

Përveç trajtimit të letrave dhe të ankesave të qytetarëve, KShH-ja ka verifikuar raste në të cilat pretendohet se ka pasur shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.

- Në datën 14 prill 2006**, në bazë të një sinjalizimi në gazetën “Shekulli”, për keqtrajtime të të dënuarve që kishin hyrë në grevë urie, KShH-ja realizoi një mision verifikimi në burgun e Rrogozhinës. Nga vëzhgimi i kryer si dhe nga kontaktet me të dënuar dhe me vetë personelin e këtij institucioni riedukimi nuk u arrit të provohej informacioni i dhënë nga media. Grupi i vëzhgimit i KShH-së diskutoi, gjithashtu, edhe me të dënuarit e futur në grevë urie, edhe me vetë drejtuesit e institucionit për shkaqet dhe për faktorët kryesorë të grevës së të dënuarve si edhe për gjetjen e zgjidhjeve në përputhje me kuadrin ligjor. Për një pjesë të kërkesave të grevës së urisë, të tilla si: rinovimi i bibliotekave të burgjeve dhe përmirësimi i cilësisë së ushqimit, KShH-ja u është drejtuar disa herë organeve përgjegjëse shtetërore për marrjen e masave për zgjidhjen e tyre.
- Në datën 21 prill 2006**, në bazë të një ankesë telefonike, KShH-ja kreu një mision verifikimi në burgun e Lezhës për verifikimin e një rasti ankesë nga një i dënuar i cili kërkonte të transferohej nga seksioni ku ndodhet aktualisht për shkak se i rrezikohet jeta. Për zgjidhjen e kësaj ankesë, grupi i vëzhgimit zhvilloi takime edhe me të dënuarin, edhe me vetë drejtuesit e këtij institucioni.

- Në datën 9 qershor 2006, KShH-ja realizoi një mision vëzhgimi në **spitalin e burgut** për verifikimin e disa ankesave telefonike të ardhura nga të dënuar dhe familjarët e tyre, si dhe të disa sinjalizimeve nga media e shkruar. Nga vëzhgimi i kryer rezultoi se ishin bërë disa lëvizje pozitive për reduktimin e numrit të të sëmurëve stacionarë si edhe për përmirësimin e kushteve higjienike, për vënien në eficiencë të laboratorit të insitucionit etj. Por problem shqetësues dhe ende i pazgjidhur ishte mbajtja në spitalin e burgut e të sëmurëve mendorë të cilët duhet të transferohen në institucione të specializuara për mjekimin e tyre.
- Në datat 16 dhe 20 qershor 2006, KShH-ja realizoi një mision sporadik vëzhgimi në **institucionet e paraburgimit nr. 302 dhe 313, në Tiranë**. Qëllimi i këtij misioni ishte monitorimi i situatës së përgjithshme të respektimit të të drejtave të të paraburgosurve në institucionet e vëzhguara. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se një pjesë e rekomandimeve të mëparshme të KShH-së drejtuar Ministrisë së Drejtësisë lidhur me respektimin e të drejtave të të paraburgosurve ishin plotësuar. Kështu, të paraburgosurve u ishin lejuar televizorët dhe frigoriferët brenda në dhomë, bibliotekat ishin pajisur me libra të rinj, marrëdhëniet me personelin në përgjithësi ishin të mira. Megjithatë, problem ende i rëndë dhe shqetësues mbetej çështja e mbipopullimit të institucioneve të vëzhguara, përmirësimi i infrastrukturës dhe i kushteve në to, furnizimi me ilaçe dhe pajisje mjekësore si edhe problemet e të paraburgosurve me organet e drejtësisë, si: zvarritjet e proceseve gjyqësore, mosnjoftimi në kohë i akuzës, mungesa e zbatimit të masave alternative etj.
- Në datën 22 qershor 2006, në bazë të një ankese telefonike nga një i dënuar nga burgu i Peqinit, KShH-ja ndërmori nismën për monitorimin e procesit gjyqësor në ngarkim të tij në gjykatën e apelit në Shkodër. Monitorimi u krye nga korrespondenti i KShH-së në Shkodër. Qëllimi i këtij monitorimi ishte vëzhgimi i respektimit të të drejtave të njeriut gjatë procesit gjyqësor. Nga raporti i monitorimit rezultoi se zhvillimi i procesit gjyqësor nga pikëpamja procedurale në ngarkim të këtij të dënuari u realizua në përputhje me ligjin.
- Në kuadër të monitorimeve me objekt respektimin e të drejtave të të dënuarve, në datën 4 korrik 2006, KShH-ja ndërmori një mision vëzhgimi në **burgun nr. 325, në Tiranë**. Nga vëzhgimi i realizuar rezultoi se të drejtat e të dënuarve në këtë institucion cenoheshin rëndë për shkak të mbipopullimit të burgut, infrastrukturës dhe gjendjes së rënduar të godinës, kushteve jo të mira higjiëno-sanitare, mungesës së një trajtimi të veçantë të të sëmurëve mendorë si edhe të një trajtimi të specializuar përmes shërbimeve konkrete ndaj të dënuarave femra.

8. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË

Gjatë periudhës janar – mars 2006, KShH-ja, nëpërmjet **6 deklaratave publike dhe 3 njoftimeve për shtyp**, ka reaguar për çështje të tilla, si: reforma zgjedhore; cenimi nga media i së drejtës së të pandehurve dhe dëshmitarëve të mitur të akuzuar ose të dëmtuar, cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë; shfrytëzimi i fëmijëve në Shqipëri; ushtrimi i dhunës fizike ose psikike, torturës dhe veprime të tjera çnjerëzore dhe poshtëruese nga forcat policore²².

²² Për më gjerë, shih aneksin nr. 1

9. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHETËRORE DHE ORGANIZATA

KShH-ja ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet shtetërore²³, kryesisht për trajtimin e ankesave të ardhura në adresë të KShH-së, për paraqitjen e problematikës së dalë nga vëzhgimi, për dhënien e rekomandimeve të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore dhe praktike etj.

Gjatë kësaj periudhe, KShH-ja ka pasur komunikim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Komisionin për Çështjet Ligjore, administratën publike, për çështje që kanë të bëjnë me administratën publike dhe të drejtat e njeriut, me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Ministrinë e Drejtësisë etj.

10. KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT DHE MEDIA

Aktivitetet e KShH-së të zbatuara gjatë periudhës janar – mars 2006 janë pasqyruar gjerësisht në media, nëpërmjet shkrimeve, intervistave dhe emisioneve. Edhe deklaratat e KShH-së gjatë kësaj periudhe janë mbuluar rreth **7 herë** nga media e shkruar dhe ajo elektronike. KShH-ja është ftuar në **1 emision** televiziv dhe ka dhënë **6 intervista, opinione dhe shkrime**. Problemet më të rëndësishme të trajtuara në to kanë qenë: reforma zgjedhore, kushtet dhe respektimi i të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve, emigrantët shqiptarë në vendet pritëse, reforma në sistemin gjyqësor dhe në burgje etj.

11. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS

11.1 Plani strategjik dhe biznesplani i KShH-së - 2007 - 2010

Përgatitja e konceptplanit strategjik

Gjatë periudhës mars – maj 2006, KShH-ja filloi përgatitjen e konceptplanit strategjik. Në mars organizoi një workshop 1- javor me asistencën e z.Klaas Astma, ekspert holandez për përcaktimin e disa përkufizimeve të planit strategjik dhe të biznesplanit.

Në këtë workshop mori pjesë i gjithë stafi i KShH-së. Bënë një inventar të fushave dhe të veprimtarive strategjike që do të punojnë në 3 vitet e ardhshme, punuan në çështje për zhvillimin financiar, për ngritje fondesh dhe për rritjen e pavarësisë nga donatorët. Në përfundim u hartua një draft planveprimi për planin strategjik dhe planin e biznesit.

Në maj u organizua një workshop 2-ditor për të diskutuar rreth fushave në të cilat do të punohet në të ardhmen, rreth metodologjisë së punës, shërbimeve që do të ofrojë KShH-ja, programeve dhe aktiviteteve etj.

Gjithashtu, për të zhvilluar më tej këtë ide, stafi i KShH-së organizoi disa takime pune. Konceptplani strategjik do të finalizohet brenda muajit tetor 2006.

Analiza e bashkëpunësuesve dhe e përfituesve të KShH-së

Në kuadër të hartimit të strategjisë, dy ekspertë të pavarur ndërmorën analizën e përfituesve dhe të bashkëpunësuesve. Ata u takuan²⁴ me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve shtetërore dhe të organizatave jofitimprurëse, organizatave ndërkombëtare dhe donatorë.

²³ Gjatë periudhës prill-qershor 2006 ka pasur 46 letra dalëse dhe 10 letra hyrëse.

²⁴ U ndërmorën 44 takime me përfaqësues të ndryshëm.

Të dhënat e mbledhura do të shërbejnë për të vlerësuar rolin e KShH-së, pritshmërinë e përfituesve dhe të bashkëpunëtorëve si dhe fushat ku duhet të veprojë KShH-ja në të ardhmen. Kjo analizë do t'i bashkëngjitet konceptplanit strategjik final.

Zhvillimi i brendshëm i organizatës

Në kuadër të planit strategjik 2007 – 2010, në datat 20 dhe 21 qershor 2006, u organizua një tjetër workshop njëditor e gjysmë. Qëllimi ishte përmirësimi i organizimit të brendshëm sipas modelit të Europian EFQM. Në këtë proces KShH-ja u asistua nga ekspertë të SNV-së. Përpara organizimit të workshopit, ekspertët e SNV-së u takuan me stafin e KShH-së për të nxjerrë pritshmëritë e workshopit, gjatë të cilit u bë një prezantim i shkurtër i rezultateve kryesore të raportit të vetëvlerësimit, i përparësive lidhur me vlerësimin e organizimit të organizatës, i koncepteve të metodologjisë dhe të metodës SMART. Stafin u organizua në dy grupe pune për të punuar më pas me çështjet kryesore me përparësi për zhvillimin e strategjisë.

Gjatë muajit qershor dhe në periudhën në vazhdim stafi i KShH-së do të punojë lidhur me çështjet e identifikuara gjatë workshopit, me profilet dhe metodologjinë e punës.

11.2 NGRITJE E KAPACITETEVE TË KSHH-SË

TRAJNIME

- Në datat **26-28 maj 2006**, Komiteti Suedez i Helsinkit organizoi në Budva (Mali i Zi) një trajnim rajonal për zbatimin e nenit 2 dhe 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Nje riut si edhe praktikës së Gjykatës së Strasburgut lidhur me këto nene. Trajnimi ishte interaktiv, pasi, krahas prezantimeve shumë të rëndësishme të lektorëve të trajnimit, u dhanë dhe shembuj praktikë nga përvoja konkrete e organizatave të ndryshme të vendeve të rajonit për sa u takon çështjeve të prezantuara përpara Gjykatës së Strasburgut. Në këtë trajnim, përfaqësuesja e KShH-së, Ersida Sefa, bëri një prezantim të shkurtër për tematikën e trajnimit si dhe për ndihmesën që KShH-ja ka dhënë dhe do të vazhdojë të japë për përmirësimin e të drejtave të qytetarëve dhe forcimit të shtetit të së drejtës.
- Në datat **28 – 29 maj 2006**, përfaqësues të KShH-së morën pjesë në trajnimin “Menaxhimi kryesor dhe aftësitë e liderimit”. Në këtë trajnim u trajtuan çështje të mënyrës së drejtimit të një organizate, të menaxhimit të veprimtarive, të burimeve njerëzore dhe financiare, të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të veprimtarive, politikëbërjet dhe strategjitë në menaxhimin e burimeve njerëzore. Në këtë trajnim morën pjesë znj.V.Hysi, drejtoreshë ekzekutive dhe znj. E.Papavangjeli, koordinatore programesh.
- Në datën **30 maj 2006**, *Co-plan-i* organizoi trajnimin “Menaxhimi i kohës”, financuar nga CORDAID-i. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte menaxhimi sa më i mirë i kohës së punës për ta bërë punën sa më eficiente dhe më pak stresuese. Në këtë trajnim mori pjesë stafi i KShH-së: znj. V.Hysi, E.Papavangjeli, K.Alikaj, E.Saliu dhe E.Sefa.

PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË NDRYSHME

1. Më 6 prill 2006 u prezantua projekti arkitekturor i ndërtimit të gjykatës së krimeve të rënda, i cili është financuar nga programi CRADS i Bashkimit Europian. Në këtë takim mori pjesë znj. K.Alikaj, juriste/as administrative

2. Më 6 prill 2006, IOM-i organizoi një takim për prezantimin e projektit “Lufta kundër migrimit ilegal”. Përfaqësuese e KShH-së në këtë takim ishte znj. E.Saliu, juriste/koordinatore projekti.
3. Në datën 8 prill 2006, Unioni i Romëve të Shqipërisë “Amaro-Drom” dhe Komiteti Shtetëror për Minoritetet, me rastin e Ditës Kombëtare të Romëve, organizuan simpoziumin me temë “Romët, sot dhe nesër”. Në këtë aktivitet mori pjesë znj.K.Alikaj, juriste/ as.administrative.
4. Në datat 10 – 11 prill 2006, u organizua konferenca “Alternativat e dënimit për të miturit në Shqipëri”, nga UNICEF-i, Ministria e Drejtësisë, Bashkimi Europian, SIDA dhe Terre des Hommes. Përfaqësuesja e KShH-së, znj. E.Saliu, juriste/koordinatore projekti, referoi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri nga këndvështrimi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.
5. Në datën 25 prill 2006, Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim, Ministria e Punës, e Çështjeve Sociale dhe e Mundësive të Barabarta organizuan një aktivitet në të cilin u prezantua raporti “Dhuna në familje. Paraqitja e situatës aktuale”. Mori pjesë znj. K.Alikaj, juriste/as.administrative.
6. Në datën 24 maj 2006, Ministria e Brendshme dhe OSBE-ja organizuan tryezën e rumbullakët: “Çështjet ligjore në përgatitjen e listës së votuesve për zgjedhjet e ardhshme”. Në këtë takim mori pjesë z.N.Jaho, këshilltar ligjor i KShH-së.
7. Në datën 29 maj dhe 7 qershor 2006 u organizua takimi për Ditën Ndërkombëtare Kundër Abuzimit të Fëmijëve në Punë nga CRCA-ja. Mori pjesë znj. E.Saliu, juriste/koordinatore projekti
8. Në datën 6 qershor 2006, Programi i Shtetit Ligjor organizoi një aktivitet për prezantimin e përfundimeve të një anketimi për korrupsionin në Shqipëri. Në këtë aktivitet mori pjesë znj.K.Alikaj, juriste/ as.administrative.
9. Në datat 7 – 8 qershor 2006, UNICEF-i, Ministria e Drejtësisë, Bashkimi Europian, SIDA, Qendra për Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve dhe Konflikteve organizuan tryezën e rumbullakët: “Drejtësia restauruese për të miturit”. Mori pjesë znj. E.Saliu, juriste/koordinatore projekti.
10. Në datat 9 qershor 2006, KShH-ja mori pjesë në konferencën “Shqipëria Jo-geto”, organizuar nga ACAC-ja. Mori pjesë znj. E.Saliu, juriste/koordinatore projekti.
11. Në datën 8 qershor 2006 u organizua tryeza e rumbullakët për prezantimin e raportit për mënyrat si të ndihmojmë gratë në nevojë, organizuar nga Aleanca Gjimore për Gratë. Në këtë tryezë mori pjesë znj. E.Sefa, juriste.
12. Më 16 qershor 2006 u organizua tryeza e rumbullakët: “Politikat sociale dhe decentralizimi” nga shoqata *Forumi i Gruas së Pavarur Shqiptare* dhe dy organizata të tjera italiane. Në këtë takim mori pjesë znj. E.Sefa, juriste.
13. Në datën 27 qershor 2006, IOM-i organizoi takimin e tretë të networkut të organizatave shqiptare. Në të mori pjesë znj. E.Saliu, juriste/koordinatore projekti.

14. Në datën 28 qershor 2006, Ministria e Jashtme organizoi takimin për mbrojtjen e minoriteteve. Në këtë takim mori pjesë znj.E.Papavangjeli, koordinatore programesh.
 15. Në datën 30 qershor 2006, Ministria e Jashtme organizoi takimin me temë: “Shqipëria dhe anëtarësia e saj në strukturat e NATO-s”. Në këtë takim mori pjesë z.Niazi Jaho, këshilltar ligjor.
-
-

ANEKS NR.1 - DEKLARATA

1. Zgjedhjet: Vonesa me pasoja

Tiranë, më 5 Prill 2006

- 1. Duke patur parasysh se ka afro 5 muaj që jemi njohur me raportin dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it lidhur me zgjedhjet e 3 korrikut 2005, si edhe faktin se Komisioni i Posaçëm Parlamentar për reformën zgjedhore nuk ka hedhur asnjë hap konkret,*
- 2. Duke patur parasysh se më datën 31 Mars 2006 ka mbaruar mandati i tre anëtarëve të KQZ-së si edhe faktin se në muajin dhjetor të këtij viti ose në janar të vitit 2007 zhvillohen zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore,*
- 3. Duke patur parasysh se ndryshimet në legjislacionin zgjedhor nuk rekomandohet të bëhen në periudhën 6 mujore para zgjedhjeve, si edhe faktin se Kodit Zgjedhor në fuqi duhet t'i bëhen ndryshime të rëndësishme,*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e shikon të nevojshme t'i drejtohet edhe një herë Kuvendit të Shqipërisë dhe gjithë partive parlamentare me thirrjen: *Më dialog dhe mirëkuptim merrni masa për kapërcimin me urgjencë të ngërçit parlamentar që ka çënuar në mënyrë të ndjeshme reputacionin e vetë organit të lartë ligjvënës. Në të kundërtën ndryshimet e nxituara në Kodin Zgjedhor mund të shoqërohen me pasoja të rënda si për përgatitjen e aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor, edhe në arritjen e standardeve që kërkohen.*

KSHH mendon se asnjë forcë politike por në radhë të parë dy partitë e mëdha të pozitës dhe opozitës, pavarësisht nga akuzat e ndërsjella, nuk mund të justifikojnë këtë gjendje në vazhdim shqetësuese.

KSHH e shikon me vend që me këtë rast të evidentojë faktin se Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe organizatat ndërkombëtare kanë dhënë sinjale domethënëse të këtij shqetësimi, ndërsa elektorati ndjek me vëmendje qëndrimin e përfaqësuesve të tij.

2. Edhe media duhet të respektojë ligjin

Tiranë, më 13.04.2006

Në median e shkruar dhe atë elektronike, shpesh publikohen fotografi të të pandehurve dhe dëshmitarëve të mitur të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra të ndryshme penale. *Publikime të tilla i ndalon ligji. Konkretisht, në nenin 130 pika 4 të Kodit të Procedurës Penale thuhet: "Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe dëshmitarëve të mitur të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç".*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, e shikon të nevojshme t'i sugjerojë medias së shkruar dhe asaj elektronike që në të ardhmen të respektojë dispozitën e mësipërme. Është fjala për të akuzuarit dhe personat e dëmtuar (ose viktimat) nga kjo apo ajo vepër penale që janë të mitur. Në të kundërtën, mosrespektimi i kësaj kërkesë ligjore mund të shoqërohet me pasoja të dëmshme të karakterit psikologjik, familjar dhe social që në raste të veçanta mund të çënojnë edhe të drejtën e privatësisë.

KSHH mendon gjithashtu se media duhet të jetë më e vëmendshme edhe në ato raste kur ka të dhëna ose dihet se vetvrasja ka ndodhur si pasojë e depresioneve psikike sepse fenomene të tilla mund të ndikojnë negativisht tek personat e tjerë.

Pavarësisht nga objeksionet e mësipërme, *KSHH vlerëson rolin e rëndësishëm të medias si edhe të drejtën e saj të pakontestueshme për të marrë dhe për t'i transmetuar opinionit publik informacionin përkatës.*

3. Të mos çenohet parimi i prezumimit të pafajësisë

Tiranë, më 18 prill 2006

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, edhe më parë, mëse një here, u ka bërë thirrje zyrtarëve, funksionarëve dhe politikanëve tanë, që në ato raste kur pretendojnë se disponojnë fakte ose të dhëna për kryerjen e ndonjë vepre penale, të bëjnë denoncimin përkatës në organet kompetente. Madje, sipas nenit 300 të Kodit Penal, *kallëzimi i një krimi që dihet se është kryer ose është duke u kryer, është i detyrueshëm.*

Deklaratat publike nga cilido që ato bëhen dhe që i vënë vulën fajësisë të këtij ose atij personi, në një kohë kur ndaj tij nuk është dhënë ndonjë vendim i formës së prerë të gjykatës, bie ndesh me parimin e sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim të formës së prerë të gjykatës”.

Për një konceptim dhe zbatim të drejtë të këtij parimi, para dy muajsh, KSHH, së bashku me organizata të tjera jo-qeveritare organizuan një tryezë të rrumbullakët ku u debatua gjerësisht ky problem.

Deklaratat e fundit publike që bëjnë fajtor Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë duke pretenduar se disponohen fakte që vërtetojnë lidhjen e tij me krimin e organizuar, korrupsionin dhe aferat e tjera, çënojnë drejtpërsëdrejti parimin kushtetues që përmendëm më lart. Si rrjedhim, qëndrime të tilla mund të shoqërohen me pasoja të dëmshme.

Në këtë të dytë reagim, KSHH ka parasysh të drejtën e Kuvendit që në mbështetje të nenit 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë t'i propozojë Presidentit të Republikës së Shqipërisë shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit. *Mirëpo ky fakt nuk legjitimon që atij t'i vihet vula e fajësisë për kryerjen e krimit pa shqyrtimin e çështjes nga organet kompetente dhe sidomos pa një vendim të formës së prerë të gjykatës.*

Në përfundim, KSHH e shikon të nevojshme të evidentojë qëndrimin konsequent të Gjykatës së Strasburgut lidhur me respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të sanksionuar në paragrafin e dytë të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kështu p.sh. në një nga vendimet e saj të 10 shkurtit 1995, ajo thekson se: prezumimi i pafajësisë nuk është vetëm një garanci procedurale në procesin penal por roli i tij është shumë më i gjerë. Bëhet fjalë për mbrojtjen e secilit nga trajtimi prej organeve dhe funksionarëve të shtetit si fajtor për kryerjen e një vepre penale para se një gjë e tillë të vërtetohet nga gjykata. (“Rreth Konventës Evropiane”, botim i vitit 2003, përkthim në shqip fq. 206, vendim Allenet de Ribbentmont kundër Francës)

4. Komiteti Shqiptar i Helsinkit Fillon Projektin Një-Vjeçar në Institutin e Paraburgimit të Lezhës me Mbështetjen e Departamentit të Shtetit të Sh.B.A.

Tiranë më 2 maj 2006

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) vëzhgon respektimin e të drejtave e lirive të njeriut dhe reagon për rivënien e tyre në vend; sensibilizon shtetasit mbi mbrojtjen e të drejtave e lirive të tyre; ndihmon përmirësimin e legjislacionit e praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave e rekomandimeve gjatë hartimit dhe më pas zbatimit të legjislacionit.

Misioni i KSHH përfshin respektimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim dhe trajtimin e tyre sipas standarteve nderkombetare e legjislacionit vendas. *Të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve janë pjesë e rëndësishme e të drejtave themelore të njeriut. KSHH ka punuar prej vitit 1998 në fushën e paraburgimit përmes projekteve vëzhguese, ndërgjegjësimit, trainimit, këshillimit, lobimit dhe oponencave ligjore, si dhe botimeve.*

Me mbështetjen financiare të Fondit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, pranë Departamentit të Shtetit të Sh.B.A., në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB), KSHH do të fillojë në muajin maj projektin një-vjeçar prej \$50 000 për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit dhe njohjes me të drejtat e njeriut e zbatimin e ligjeve nga administrata e paraburgimit në burgun e Lezhës.

Disa nga objektivat kryesorë të veprimtarive të planifikuara do të jenë:

- Të përmirësohen standartet e të drejtave të njeriut në institucionin pilot të paraburgimit;

- Të rritet shkalla e njohurive teorike e sidomos atyre praktike të administratës së seksionit të paraburgimit, Lezhë;
- Të nxitet e mbështetet ndryshimi i mendësive në trajtimin e të paraburgosurve;
- Të aftësohet administrata e paraburgimit për të marrë nisim për hartimin e një plani veprimesh për të mundësuar drejtimin e paraburgimit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut; dhe
- Të ndërgjegjësohen të paraburgosurit mbi të drejtat dhe mekanizmat mbrojtës të këtyre të drejtave, e të ofrohen këshillime ligjore falas për të paraburgosurit në këtë institucion.

Për zbatimin e projektit, KSHH do të përfshijë ekspertë të huaj me shumë përvojë në drejtimin e institucioneve penitenciare, juristë të kualifikuar në fushën penale, veprimtarë e vëzhgues të të drejtave të njeriut, dhe një staf të përkushtuar e me përvojë përkatëse.

Një nga synimet e projektit është që paraburgimi pilot i Lezhës të shërbejë si model për paraburgimet e tjera në varësi të Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të mirëmenaxhimit të institucioneve penitenciare ku respektohen të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i të paraburgosurve.

5. Deklaratë për shtyp

Tiranë, më 4 Maj 2006

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizata e parë jo-qeveritare e cila është themeluar më 19 Dhjetor 1990 si Forumi për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut. Më 22 mars 1992, organizata u anëtarësua pranë Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me emërtimin Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Misioni kryesor i KSHH-së është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, rivendosja e të drejtave të shkelura, ndërgjegjësimi i shtetasve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre dhe përmirësimi i legjislacionit dhe i praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave dhe rekomandimeve. Pjesë e këtij misioni është, gjithashtu, edhe rritja e përgjegjshmërisë së administratës publike në zbatimin me korrektësi të ligjit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të kësaj administrate.

Një ndër drejtimet kryesore të veprimtarisë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të minoriteteve në Shqipëri. Si organizata e parë jo-qeveritare në vend, KSHH ka një eksperimentë pothuajse 15-vjeçare në fushën e minoriteteve.

Në kuadër të veprimtarisë së tij në fushën e minoriteteve, KSHH do të fillojë zbatimin e një projekti të ri në Bashkinë e Korçës me titull "Monitorimi i Ushtrimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës". Duke qenë një qytet me 4 minoritete (maqedonas, rom, arumun) dhe një komunitet, atë egjiptian, Korça u përzgjedh si qyteti i parë model për zbatimin e projektit.

Qëllimi i projektit është vlerësimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në këtë qytet, dhe evidentimi i mundësive për zhvillimin e tyre. Gjithashtu, nëpërmjet tij synohet të rritet pjesëmarrja e minoriteteve në vendimmarrje vendore dhe të forcohen marrëdhëniet e tyre me pushtetin vendor. Zbatimi i këtij projekti do t'u japë qytetarëve një mjet për të përfitur nga veprimtaria e administratës vendore dhe për të propozuar përmirësimin në politikat e tyre për minoritetet. Në të njëjtën kohë ai do të ofrojë një mjet për vet-vlerësimin e autoriteteve vendore dhe do të jetë një mënyrë për përmirësimin e kapaciteteve të tyre për problemet e adresuara nga qytetarët.

Për zbatimin e tij, KSHH do të ketë një bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen vendore dhe konkretisht me Këshillin Bashkiak të Korçës. Projekti do bazohet në anketimin e qytetarëve. Gjithëpërfshirja e qytetarëve të bashkisë Korçë në përgjithësi dhe e përfaqësuesve të minoriteteve në veçanti do të jetë element i rëndësishëm për një vlerësim sa më objektiv të gjendjes së të drejtave të minoriteteve në këtë Bashki.

Në fund të zbatimit të projektit do të hartohet një raport i cili do të bazohet në përpunimin e të dhënave që do të dalin nga anketimet e kryera. Në dhjetor 2006 do të organizohet një tryezë e rumbullakët ku do të paraqiten përfundimet kryesore të raportit të punuar. Në tryezë do të jenë të ftuar aktorë të ndryshëm të Bashkisë Korçë që kanë dhënë kontributin e tyre në zbatimin e projektit dhe/ose të interesuar në këtë fushë.

Bashkia e Korçës është përvoja e parë e këtij lloji e cila mendohet të shtrihet edhe në qytete të tjera të Shqipërisë ku ka minoritete dhe komunitete.

Ky projekt realizohet me mbështetjen financiare të Friedrich Ebert Stiftung.

6. DEKLARATE PER SHTYP - NDAL PUNES DHE SHFRYTEZIMIT TE FEMIJEVE NE SHQIPERI

Tiranë, 12 qershor 2006 – Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA, Diagonia Agapes, Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë Civile, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe Shoqata Kristiane e Grave, janë të shqetësuara përse i përket shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar dhe lypje në Shqipëri.

Puna e fëmijëve në përgjithësi dhe fëmijët të rrugës në veçanti, si forma të shfrytëzimit ekonomik dhe punës së detyruar të fëmijëve në Shqipëri, përbëjnë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Punësimi i fëmijëve bëhet në kundërshtim të hapur me legjislacionin kombëtar dhe standartet ndërkombëtare të OKB-së dhe ILO's.

Praktika ka treguar se në mjaft raste prindërit e fëmijës janë njëkohësisht edhe shfrytëzuesit e fëmijës.

Mungesa e një ligji të përshtatshëm për ndalimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijës, rrezikon që ta kthejë punë e fëmijëve në një krim akoma më të rrezikshëm sesa trafikimi i fëmijëve, pasi ai shtrihet në një territor më të gjerë dhe nuk është i dënueshëm. Mungesa e sanksioneve ndaj familjeve që shfrytëzojnë krahun e punës së fëmijës, qoftë në Kodin e Punës, Kodin e Familjes dhe në Kodin Penal, bën që fëmijët të gjenden të pa mbrojtur nga ligji dhe institucionet e zbatimit të ligjit.

Sipas statistikave zyrtare mëse 9.8 përqind e fëmijëve të moshës 6-14 vjeç në Shqipëri shfrytëzohen ekonomikisht, ndërsa sipas një studimi të CRCA, mëse 50 mijë fëmijë në Shqipëri janë përfshirë në fenomenin e punës së fëmijëve dhe fëmijëve të rrugës. Megjithatë sistemi i mbledhjes të të dhënave për fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës është i vjetër, dhe si pasojë, të dhënat nuk i vijnë në ndihmë Qeverisë shqiptare për të bërë një analizë të drejtë të situatës, si dhe për përgatitjen e politikave të përshtatshme për këtë grup shoqëror.

Qeveritë shqiptare, gjatë këtyre 15 vjetëve kanë treguar një mungesë vëmendjeje për eliminimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve dhe për zhdukjen e shkaqeve që ndikojnë në praninë e punës së fëmijëve. Mungesa e politikave qeveritare për fëmijët që punojnë ose për fëmijët e rrugës, është një tregues i neglizhencës së të treguar nga çdo Qeverie shqiptare deri më sot, për të ndërtuar një treg pune, i cili respekton të drejtat bazë të fëmijëve dhe mirëqënien e tyre.

Organizatat nënshkruese të kësaj deklarate dëshirojnë të sjellin në vëmendje të opinionit publik, të qeverisë shqiptare dhe të gjithë institucioneve përgjegjëse për mirëqënien e fëmijëve se:

1 Fenomeni i punës së fëmijëve dhe i fëmijëve të rrugës, ka lidhje të drejtëpërdrejtë me krimin e trafikimit të tyre. Fakti që puna e fëmijëve zhvillohet më së shumti në rrugë, i bën fëmijët viktima të mundshme të veprave penale të ndryshme si rrëmbimi dhe trafikimi i tyre. Kjo tregon edhe një herë se këta fëmijë janë më të rrezikuarit për t'u përdorur për trafikim të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

2 Një pasojë tjetër e rëndë e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, është përfshirja e tyre në vepra penale apo grupe të organizuara të krimit. Puna e fëmijëve në rrugë, në mënyrë të natyrshme, ka krijuar një treg të shpërndarjes së mallrave në sasi të vogla. Ekziston një mundësi reale që ky treg të shfrytëzohet për shpërndarjen e lëndëve narkotike nga vetë fëmijët, të afërmit e tyre ose persona të tjerë të interesuar të shfrytëzojnë punën e fëmijëve.

3 Pasojat e përfshirjes së dhjetra-mijëra fëmijëve në punë në një moshë tepër të vogël dhe të papërshtatshme, nuk janë vetëm pasoja individuale, por edhe kombëtare. Një nga rreziqet që çdo Qeveri do të përballlet në të ardhem e afërt, është mungesa e burimeve njerëzore profesionale, të afta për t'u përballuar me tregun evropian, pjesë e të cilit Shqipëria aspirojnë të bëhet.

4 Mos-arsimimi i duhur i fëmijëve ka për ta bërë tepër të vështirë integrimin e tyre në tregun e punës

shqiptar dhe atë evropian. Si pasojë një pjesë e mirë e këtyre fëmijëve edhe kur të rriten do të kenë nevojë për ndihmën sociale dhe financiare të shtetit, kosto të cilat duhet të mbulohen nga çdo taksapagues shqiptar.

5 Ndonëse shteti shqiptar ka nënshkruar shumë marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare, shfrytëzimi i fëmijëve për punë tregon se Shqipëria nuk përmbush detyrimet e saj minimale në këtë fushë.

Organizatat joqeveritare besojnë se vetëm nëpërmjet marrjes së masave urgjente nga Qeveria shqiptare dhe institucionet e saj, ne mund të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë fëmijët tanë, në mënyrë që fëmijët të mos shfrytëzohen më ekonomikisht dhe të mos detyrohen të punojnë si skllëvër në Shqipëri.

16. Ushtrimi i dhunës fizike ose psikike është i patolerueshëm dhe dënueshëm

Tiranë, më 19 Qershor 2006

Sipas njoftimeve të shtypit, më 17 Qershor 2006, i mituri Amarildo Përfundi, nxënës i vitit të tretë, të shkollës së mesme të fshatit Pirq të rrethit të Korçës i ka dhënë fund jetës. *Komiteti Shqiptar i Helsinkit dëshiron të shprehë ngushëllimet e tija familjes së të ndjerit dhe në të njëjtën kohë shpreh shqetësimin për humbjen e jetës të të riut.*

Pavarësisht nga rrethanat dhe motivet që e kanë çuar viktimën në këtë tragjedi të dhimbshme, KShH-ja i bën thirrje Prokurorisë së Rrethit të Korçës që ta hetojë këtë çështje me përparësi dhe paanshmëri duke verifikuar deri në fund dhe në mënyrë të gjithanshme pretendimet e prindërve të tij se viktima është keqtrajtuar nga organet e policisë.

Me këtë rast, KShH-ja dëshiron të sjellë në vëmendjen e publikut dhe të institucioneve përgjegjëse se gjatë viteve të fundit, ankesat e shtetasve për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë nuk kanë qenë të pakta

KSHH, pa paragjykuar aspak rastin e viktimës A. P duke patur parasysh se kemi të bëjmë me një të mitur që vendosi t'i japë fund jetës së tij, e shikon të nevojshme të verë në dukje detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar dhe ai ndërkombëtar i ratifikuar nga Shqipëria lidhur me trajtimin e të miturve në kontakt me policinë dhe organet e drejtësisë, pavarësisht nga pozicioni i tyre.

Në çdo rast dhe për çdo arsye punonjësit e policisë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore *janë të detyruar të tregojnë një kujdes të veçantë ndaj të miturve* që dyshohen për kryerjen e ndonjë vepre penale, që mund të jenë dëshmirë ose viktima të një krimi, duke zbatuar me rigorozitet normat e Kodit të Procedurës Penale, legjislacionin për të mitur.

Nga familja e të miturit është pretenduar për ekzistencën e shenjave të dhunës në trupin e djalit të tyre. KSHH, pa paragjykuar këto pretendime dëshiron të citojë vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen “RIVAS kundër FRANCËS”, ku shprehet se “kur një person mbahet nga policia, shteti merr përsipër detyrimin pozitiv që të sigurojë mirëqënien e tij. Ky parim gjen zbatim *a fortiori* (aq më tepër) ndaj të miturve. Çdo dëmtim i pësuar gjatë mbajtjes në polici i ngarkohet në mënyrë automatike shtetit përveçse kur Gjykata bindet se është ofruar nga ky i fundit një shpjegim i pranueshëm për të hedhur poshtë këtë prezumim”. Madje *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e konsideron çnjerëzor dhe degradues trajtimin që shkakton dhimbje ose vuajtje fizike dhe mendore, dhe duke patur parasysh moshën, t'i krijonin të miturit ndjenjën e frikës, ankthit, inferioritetit të tilla që ta përçmonin de përulnin atë dhe mundësisht të thyenin rezistencën e tij fizike dhe morale.*

Sipas nenit 49 të Kodit të procedurës penale kur personi ka mbushur moshën 18 vjeç, detyrimisht atij duhet t'i caktohet mbrojtës dhe pyetja duhet të bëhet në praninë e tij. Gjithashtu, policia mbart detyrimin të njoftojë familjarët ose të afërmit e tij *sapo i mituri shoqërohet në polici si dhe informohet për arsyet e shoqërimit, të drejtat që ka dhe të asistencë psikologjike dhe ligjore.*

Ky detyrim ligjor është parashikuar edhe në legjislacionin ndërkombëtar. Konkretisht, në nenin 10 të Tërësisë së Rregullave Minimale të Kombeve të Bashkuara në lidhje me Dhënien e Drejtësisë për të Mitur përcaktohet se “*Porsa një i mitur është ndaluar, prindërit ose kujdestari i tij, njoftohen menjëherë ose në*

rast se kjo është e pamundur ajo duhet të bëhet brenda një afati sa më të shkurtër. E më tej në kontaktin e të miturit me organet e policisë duhet të favorizohet mirëqënia e tij dhe të mos i bëhet dëm atij...”. Kjo është e rëndësishme pasi kontakti mund të ndikojë thellë në qëndrimin e të miturit.

KShh-ja i bën thirrje Ministrisë së Brendshme, në mënyrë të veçantë Policisë së Shtetit:

- 1 Të respektojnë me përpikmëri ligjin dhe të trajtojnë me dinjitet dhe në përputhje me ligjin dhe moshën cilindo person në kontakt me ta.*
- 2 Të tregojnë kujdes për të gjithë personat në kontakt me ta, pavarësisht se mund të jenë të dyshuar, autorë, dëshmitarë.*
- 3 Të tregojnë më shumë kujdes dhe vemendje për të miturit dhe viktimat e krimit.*
- 4 Të mos lejojnë që në gjirin e tyre të ketë ende punonjës policie që ushtrojnë dhunë fizike dhe psikike.*

8. Ushtrimi i torturës-akt çnjerëzor dhe poshtëronjës

Tiranë, më 26 Qershor 2006

Komiteti Shqiptar i Helsinkit si një organizatë jo-fitiprurëse misioni i të cilit ka qenë dhe mbetet mbrojtja e lirive dhe të drejtave të shtetasve në ditën ndërkombëtare të luftës kundër torturës, rithekson nevojën e parandalimit të këtij fenomeni sa të dëmshëm, aq edhe çnjerëzor dhe poshtëronjës. *Me këtë rast, u bëjmë thirrje organeve të specializuara që veprojnë kundër kriminalitetit në tërësi dhe atij të organizuar në veçanti që të respektojnë jetën, shëndetin dhe dinjitetin e personave që dyshohen për kryerjen e këtij apo atij krimi.*

KSHH e shikon të nevojshme të evidentojë faktin se konceptimi më i drejtë i nocionit të torturës kërkon edhe ndryshimet në legjislacionin tonë me qëllim që ajo të përqaset me dokumentat ndërkombëtare dhe me legjislacionin demokratik bashkëkohor.

Në këtë vështrim, KSHH përshëndet nismën e Avokatit të Popullit për një përcaktim më të drejtë të nocionit të torturës. Kjo edhe për faktin se në praktikë ka raste kur disa veprime arbitrare që kanë elementë të torturës cilësohen si vepra të thjeshta në dëm të shëndetit apo si shpërdorim të detyrës.